

Nafie Berisha-Latifi

Gazetare dhe redaktore



Në foto: Nafie Berisha-Latifi

Nga arkivi personal i Nafije Berisha-Latifit

Unë jom Nafie Berisha-Latifi, e lindun me 20 janar 1950, në fshatin Dubravë të Kaçanikut. Shkollën fillore edhe të mesme i kom kry në Ferizaj, ku kemi jetu mandej. Kom fillu studimet në vitin '70, në fakultetin asokohe Filozofik, tani Filologjik, për Gjuhë e Letërsi Shqipe, Albanologji. I gjithë interesi im nga fëmijëria ka qenë leximi, leximi, leximi, edhe përveç obligimeve ditore e shkollore e gjithëfare, unë jom mundu me lexu çdo gja të mundshme. Domethanë biblioteka e shkollës dhe e qytetit të Ferizajit për mu ka qenë e tejkalume qysh në klasën e shtatë, tetë. Kom hulumtu masnej, menxi gjejshim librat asokohe, kom lexu gjithçka, edhe në gjuhën serbe sepse kemi pasë literaturë të kufizume në gjuhën shqipe. Shkrimtartë e hujë, shkrimtartë e njoftun kanë qenë përgjithësisht të përkthymë në gjuhën serbo-kroate dhe unë i kom lexu [qeshë]. Të i'u them sinqerisht për moshën t'a zamë 12 e 15 vjeçare t'a lexosh një Frojd osë një Kafkë, ose një, një... shkrimtar të njoftun, një filozof të njoftun, pastaj edhe Heminguej atëherë s'ishte shumë i kuptushëm për moshën time. Por unë vazhdoja të lexoj. Më kujtohet libri i parë që m'a ka shty dëshirën për lexim ka qenë "Robinson Kruzo", dhe e përjetojsha atë libër në çdo lëvizje të atij

personazhit, në çdo frikë, në çdo problem jetësor, ekzistencial, në atë ujëdheshën ku ka mbetë i vetmumë, edhe ku ka qenë i rrezikumë, edhe sot më kujtohet si film ai libër. Aq shumë e kom lexu, aq shumë e kom përjetu, e kështu me radhë.

<<< Ambient në klasë >>>

Në shkollën e mesme Normale, kom qenë nxanëse e dallume për hartime, dhe ato hartimet pastaj më kanë nxjerrë edhe për landë të cilat nuk i kam njoftë shumë mirë. T'a zomë matematikën e tjerë, kanë mendu që unë i di të gjitha, nëse di me shkru ni hartim të mirë, e ni hartim që dallohej në shkollë, e lexohej nëpër të gjitha klasat e... kjo ka ardhë si rezultat i leximit të shumtë të librave.

Ka qenë gëzim i jashtëzakonshëm që po të pranojnë në "Zërin e Rinisë". Ni revistë të vetme e cila është shpërnda nëpër gjithë Kosovën edhe i ka... ka pasë shkrime për, afirmative kryesisht. Na jemi munu me thanë, me i afirmu rastet e mira, me i afirmu nxanësat e mirë, studentët e mirë, punëtorët e mirë nëpër fabrika, nëpër gjithkah, nëpër institucione, nëpër shkolla, nëpër... Në mënyrë që me qenë si shembuj të mirë, që dikush pas tyre me ndjekë atë rrugë. Domethanë ky ka qenë mesazhi jonë, shume pozitiv. Nuk kemi vrapu mas skandaleve, nuk kemi vrapu mas spektakleve, por jemi mundu që me vu në pah çdo të mirë të popullit, çdo të mirë të vendit, dhe me kontribu në qat mënyrë, me bo atë ma të mirën që kishim na mundësi si gazetarë. Të njëjtin pasion e kom vazhdu edhe tash, megjithëse tash nuk e kom më koncentrimin për gjithë atë që e lexoj, nuk po e mbaj në mend. Ndoshta edhe mosha, edhe mendja që shpërndahet herë mas herë, fluturon dikah, kah osht' mirë, e kah s'osht' mirë... po jeta qysh t'i sjellë momentet.

Në fakultet, që në vitin e parë jom dallu, hartimet e mia janë dallu, punimet e mia me shkrim janë dallu, prandaj më kanë ftu me qenë pjesë e revistës studentore "Bota e Re". Dhe aty prej vitit të parë kom fillu punën. Pastaj më kanë thirrë në "Zërin e Rinisë", dhe atëherë e vetmja revistë për të ri ku kom fillu me punu me rojë. Por të ju them, gjatë gjithë kohës unë kom punu në dy, tri revista, sepse në njënen kom qenë me obligim, e tjetrën kom qenë me honorar i thojshin atëherë. Kom punu në "Zërin", pesë, gjashtë vjet, fillimisht gazetarë fillestare, gazetarë e kategorive t'parë e t'dytë, sepse asokohe duhej me kalu shumë përvoja për me arritë kategoritë, avancimin në profesion. Kam qenë bashkëpunëtorë edhe e "Kosovares", revistës së vetme për femna, e për familje, në të cilën kom kalu pastaj si gazetarë redaktore, edhe aty kom punu ni kohë të gjatë, tash s'po më kujtohen vitet. Kom punu edhe në "Shkëndija" si redaktore. "Shkëndija" ka qenë revistë për arsim, dhe njëkohësisht kom punu ku kom pasë kërkesa me dërgu shkrime. Në vitin 2000, do të thotë kur kishim shumë probleme për nxjerrje të revistave, kur gjysma e revistave mbusheshin me informata të Rilindjes, sepse Rilindja u ndalu, dhe gazetartë informatat i plasojshin në revista, në "Shkëndija", në "Zëri", në "Fjala", në "Bujku", dhe përfundimisht mbetën te "Bujku", sepse "Bujku", ka qenë i regjistrumë por nuk ka qenë aktiv, dhe metën me emërtim "Bujku". Po që s'kish t'boj fare as emërtimin, as me qëllimin e themelimit të asaj reviste. Ishte një Rilindje me emër tjetër. Gjysmën e bojshim na të revistave, gjysmën e bojshin puntortë e Rilindjes, gazetartë. Mund të them, se Rilindja përgjithësisht, prej themelimit ka qenë shkollë e gazetarisë, e publicistikës, edhe shkollë e intelektualëve të Kosovës. Aty kanë punu filimisht prej themelimit, kanë qenë emrat shumë të mëdhaj, kanë qenë atdhedashës,

njerëz dashamirës të kombit, që dalëngadalë e kanë fillu gazetarinë edhe publicistikën në Kosovë. Kanë qenë emra të mëdhaj, ka qenë Esad Mekuli, Tajar Hatipi, Ali Hadri, Mark Krasniqi, Hivzi Sylejmani si gjeneratë e parë e themeluesëve të revistave. Pastaj ka ardhë gjenerata tjetër, Ali Sutaj, i cili njihet si themelues, si babë i revistave. Ai ka pasë aq shumë sens me gjetë mundësinë, situatën, për me themelu edhe me plasu në revistë, që ka qenë e jashtëzakonshme. Sepse sigurisht asokohe, po mendoj, pushteti, shteti, nuk ka qenë shumë dashamirës i arsimimit edhe i kulturalimit të shqiptarëve. E kjo gjeneratë e parë dhe e dyta pastaj, kanë bërë çdo gjë të mundshme, që me i gjetë rrugë me mbërri të popullata, të lexuesit, të rinia, të shkollatë, të të gjithë. Dhe mund të them se kontributi i Rilindjes me revistat... sepse revista ka qenë njësi e veçantë, kanë qenë të jashtëzakonshme.



Puna gjatë terrenit

Në foto: nga e majta në të djathtë Vahide Hoxha, Nafie Berisha Latifi

Nga arkivi personal i Nafije Berisha-Latifi

Unë si gazetare e “Zërit të Rinisë”, unë kam qenë vet e re, studente e vitit të parë e të dytë, në çdo shkrim tonin, në çdo reportazh, në çdo intervistë jemi mundu që me dhonë një mesazh. Në mesazh që sidomos vajzat asokohe kanë qenë të mbylluna, të pashkolla, ka qenë numër i kufizumë i femrave që janë shkollu, kryesisht atyne që kanë banu në qytete. Wl kemi nxitë me ikë nga fejesat e hershme, asokohe ka qenë në dukuri e fejesave të hershme. Dhe vajza përveç penegesave që i ka pasë në familjen e vet, ka pasë pengesa edhe nga familja e të fejuarit. I’u kemi premtu shumë edhe i kemi realizu të gjitha ato, sepse me vet faktin që i kemi nxitë me ardhë në shkollë ato kanë ikë... edhe sot e mendoj çfarë tmerri ka qenë me ikë ta zamë prej në fshatit të Istogut.

<<< Ambient i ecjes në pyll natën >>>

E me ardhë natën, as s'ka pasë autobus, as s'kanë ditë rrugë, as s'kanë ditë... s'kanë pasë mundësi. Rreziku i mosgjetjes së rrugës, rreziku i pyjeve... po mendoj problemeve që i kanë kalu në ato nëpër ato rrugë, nëpër male, nëpër fusha, nëpër ara, nëpër... ku e di kah. Krejtë kanë mbërri, kanë ardhë edhe e kanë gjetë "Zërin e Rinisë". Redaksinë e "Zërit të Rinisë", që ka qenë asokohe, revistat kanë qenë të instalume, këtu pas policisë. Kanë qenë do baraka... do baraka të vogla, edhe ato e kanë gjetë mundësinë me ardhë aty para mëngjesit ndoshta, në çfarë do kohe, dhe kur kemi shku na, i kemi mirëpritë, i kemi ushqy, i kemi qu nëpër konvikte të shkollave të mesme ka qenë, ku është tash AUK-i, ka qenë konvikti i shkollës Normale. I kemi regjistru në cilën shkollë kanë pasë dëshirë ato, kryesisht kanë qenë të orientume kah shkolla e Mjekësisë. I'u kemi dhonë bursë, i kemi mbështetë materialisht, e moralisht e. Kemi pasë kujdes te jashtëzakonshëm që ato vërtetë me kry shkolla e me qenë shembull për vajzat tjera që mbeteshin në fshat. Me qenë shembulli i tyre, që nëse ato e kijnë shkollën me sukses e nuk e ndrojnë rrugën edhe qëllimin për çka kanë ardhë. Ato do të jenë shembull për vajzat tjera.



30 vjetori i themelimit të revistës "Zëri i Rinisë", 1975

Në foto: Nafie Berisha-Latifi dhe kolegët e saj

Nga arkivi personal i Nafije Berisha-Latifit

Kom qenë e vetmja femën, kolegtë mashkuj që kanë pasë shumë respekt për mu jashtëzakonisht, kanë qenë emna të njoftun të gazetarisë, ma të vjetër se unë, por kanë pasë shumë respekt për mu, aq ma tepër kur e kanë pa që unë vërtetë jam e përkushtume në punë shumë. Dhe e kanë çmu edhe punën, edhe sjelljen edhe personalitetin tem ta thom. Kemi shku në terren me ni veturë, tre gazetarë, ni fotoreporter, vozitësi, ta zamë kemi shku mbrenda ditës në tri, katër qytete, njëni është nalë aty, tjetri aty, aty, i ka ba dy tema aty, tjetri. Shumë kemi punu, edhe mendoj që puna as s'na ka lodhë, përkundrazi. Çdo të shtune, që ka dalë revista, unë e kom marrë e kom kontrollu çdo presje të shkrimit tem, edhe jom gëzu në shumicën e rasteve, po edhe kom pase vërejtje natyrisht për diçka që s'e kom përfshi ose e kom haru, ose që në ndërkohë kom menu që ka qenë ma e rëndësishme. Mendoj që gazetaria osht' profesioni ma atraktiv në botë, sepse ti njeh shumë njerëz, shumë vende, shumë situata, shumë raste, shëtitë edhe botën. Unë në vitin 1973, kom marrë pjesë në festivalin ndërkombëtar në Gjermani Lindore, ku kanë marrë pjesë 140 delegacione të shteteve të ndryshme. Asokohe e kom kalu murin e Berlinit tre herë. Domethonë ka qenë një përjetim i jashtëzakonshëm, që përndryshe privatisht nuk kisha mujtë as me shku, as me përjetu. Pastaj kom shëtitë nëpër Evropë dy herë, kom përcjellë shëndetësi, arsim, ekonomi e të gjitha degët, edhe kemi qenë t'a them jo të profolizumë për një lami. Kështu që, u dashtë për çdo temë me u përgatitë posaçërisht. Nëse ti sot shkon bisedon me ni mjek, ti duhesh t'jesh e përgatitun për çka ki me pytë, për çka ki me folë, nëse nesër shkon flet me ni jurist, me ni doktor të drejtësisë ta zomë, ose, edhe për atë situatë duhej me u përgatitë. As s'i kemi pasë mundësitë e internetit, as s'i kemi pasë mundësitë e informatave, burimeve të shumta, po secili ka grabitë ata që ka mujtë. Gazetat, revistat, në gjuhë serbo-kroate, maqedone, unë kom jetu edhe ni kohë edhe në Shkup, e edhe maqedonishten, gjuhët sllave domethanë, lehtë mësoheshin. Domethonë kemi përcjellë çdo gja, për çka ka pasë nevojë. Kom qenë edhe redaktore e modës, e kuzhinës, e shumë, shumë rubrikave që iu kanë interesu të rive. Kemi pasë për shembull pyetje për edukatën seksuale, asokohe, letra të dashurisë, shumë çka që e ka preokupu ni të ri të kohës.

Për shkak të këtij pasioni aq të madh ndaj shkrimit, ndaj revistave, ndaj gazetave, unë në vitin 2000 e kom themelu këtë, revistën teme për të ri "Rreze", me ndihmën e zyrës Amerikane. Atëherë ka qenë zyre amerikane, e jo ambasadë. E kom bo ni projekt edhe e kom bo ni kërkesë që meniherë ma kanë financu. Edhe për katër vjet, unë e kom botu revistën teme. Une kom pasë kolegë që e kanë bo temën për 20 minuta, une për dy orë mezi e kom bo. Dhe prap jom kthy.... e në "Rreze", në qat' revistën që e pata bo, këta gazetarë e ri thojshin, "Mos ja leni me lexu për s'dyti se prap ka me naj ndërru kjo, ka me ndërru". Çdo herë që e lexojsha, çdo herë gjejsa diçka të re, ni ide të re, ni ndryshim të qasjes, ni prezantim tjetër, ni... është e pafund mundësia, imagjinata e njerit që shkrinë, ose që lexon. Asnjona nuk e kupton ni libër nisoj, asnjona nuk e kupton ni vepër arti nisoj, kështu që... unë ndoshta si person jom e tillë që me jap hakun, ia jap krejt mundësinë teme.

Në vitin 2004 jom sëmu, jom diagnostiku me kancer gjiri, dhe për mu ka qenë shok, jo që po vdes, s'e mendojsha që vdes, po që mbet revista, edhe njo dy, tre numra e kisha grantin për me nxjerrë revistën... edhe, kush ka me marrë? Kolegtë e mi nuk e morrën, se në qat' mënyrë qysh punojsha une edhe pa rrogë, krejtë qato pare që më ipeshin ja u jepsha këtyne gazetarëve me i motivu diqysh. Kolegtë m'thojshin, "Ata neve duhet me na dhonë, që po ja u qesim shkrimet e

para, e ti a je bre normal i ke lazdru këta fëmijë”. Nejse, si do qoftë ajo ka qenë mënyra jeme e sjelles, me disa prej tyne tash janë redaktorë nëpër televizione, nëpër media.

Unë e kom dashtë gazetarinë, unë e kom dashtë punën teme.



Në foto: Nafie Berisha-Latifi

Nga arkivi personal i Nafije Berisha-Latifit